



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.1675/2017

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hunaida Pasuli – Kryetare e kolegjit, Gani Avdiu dhe Faton Ademi anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.N. nga Peja, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.N., avokat në Pejë, kundër të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ardian Rexha-zyrtar ligjor, me bazë juridike kompensimi i dëmit për shkak të mospagesës së pagave mujore, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr. 200/2015, të datës 03.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.01.2021, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit F.N. nga Peja, Rr. “Nëna Terezë” nr. 119, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr. 200/2015 i datës 03.02.2017, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë me aktgjykimi C.nr. 200/2015 të datës 03.02.2017, ka vendosur si në vijim:

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit F.N. nga Peja Rr. “...” nr. ..., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës në Prishtinë paditësit t’ia paguaj shumën prej 7.059,00€ (shtatë mijë e pesëdhjetë e nëntë euro) në emër të dëmit të shkaktuar material për shkak të mospagesës së pagave mujore për periudhën kohore nga data 01.01.1992 deri me dt. 01.02.2000, në cilësinë e punëtorit të ish Gjykatës Komunale në Pejë-tani Gjykata Themelore në Pejë - Divizioni për Kundërvajtje, me kamatë vjetore prej 8% nga dita e vendosjes e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 678€ të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, si e pabazuar në ligj.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të aprovoj ankesën, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj me aprovimin e kërkesëpadi së paditësit si të bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 14.02.1992 në Gjykatën Komunale në Pejë paditësi kishte parashtruar padi kundër të paditurit Organi Komunal për Kundërvajtje në Pejë me kërkesë për anulimin e aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Meqenëse pas vitit 1999 paditësi ishte rikthyer në punë, kështu me parashtruesën e datës 07.07.2016, ka rregulluar padinë ashtu që si kërkesë kryesore nga padia ka parashtruar kompensimin e të ardhurave personale nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri me datë 01.02.2000, kur paditësi është rikthyer në marrëdhënie pune në Gjykatën për Kundërvajtje në Pejë (Ndërsa, në aspektin subjektiv rregullimi i padisë është parashtruar në drejtim të palës së paditur Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si suksesor i të paditurit Organi Komunal për Kundërvajtje në Pejë.

Duke vepruar sipas padisë gjykata e shkallës së parë me qëllim të vlerësimit të pretendimeve nga padia dhe vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën për administrimin e provave, me leximin e shkresave të lëndës C.nr. 142/92; C.nr. 848/96; C.nr. 1086/98; vërtetimit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Kundërvajtje AGJ.nr. 109/16, dt. 20.09.2016 dhe ekspertizës financiare të datës 13.11.2016 të ekspertit gjyqësor Ukë Sadikaj. Mbi bazën e provave të nxjerra gjykata e çështjes ka ardhur në përfundim se kërkesëpadi e paditësit për kompensimin e pagave në shumën e kërkuar prej 7059€ për periudhën kohore 01.01.1992 deri me datë 01.02.2000, është e pabazuar dhe të njëjtën e refuzoi duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit gjykata ka parashtruar se nuk ishte kontestues që paditësi në vitin 1992, ka inicuar procedurën kontestimore kundër të paditurit Organi Komunal për Kundërvajtje në Pejë për anulimin e aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e cila kërkesëpadi nga gjykata e shkallës së parë është aprovuar si e bazuar, mirëpo sipas ankesës, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është prishur dhe lënda është kthyer në rigjykim. Duke qenë se lënda ka mbetur e papërfunduar, paditësi në vitin 2007 ka kërkuar vazhdimin e procedurës. Gjykata ka shtuar se si çështje kontestuese paraqitet legjitimiteti pasiv i palës së paditur. Me referim në faktet e rastit gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret edhe pse ekziston legjitimiteti i palës së paditur, megjithëkë mungon baza juridike e kërkesëpadi së përderisa vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk është anuluar me vendimm përfundimtar gjyqësor.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi gjykata e çështjes në raport me faktet e vërtetuara në këtë çështje kontestimore, ka ardhur në përfundimin e drejtë se në rastin konkret mungon baza juridike e kërkesëpadisë. Për më tepër, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë edhe në situatën nëse do të rezultonte se me vendim gjyqësor të formës së prerë ishte anuluar si i kundërligjshëm vendimi i Organit Komunal për Kundërvajtje (me të cilin vendim paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës) prapëseprapë nuk do të plotësoheshin kushtet ligjore për ta detyruar tani të paditurin Këshillin Gjyqësor të Kosovës që paditësit t'ia kompensoj të ardhurat nga marrëdhënia e punës për periudhën kohore nga data 01.01.1992 deri më 01.02.2000, pasi këtu i padituri nuk ka qenë pjesëmarrës i marrëdhënies materialo juridike nga e cila ka lindur kontesti, përderisa nuk ka ndërmarrë asnjë veprim nga i cili mund të konstatohet se paditësit ia ka cenuar ndonjë të drejtë nga marrëdhënia e punës. Në këtë kuptim, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se në rastin konkret në të vërtetë të paditurit KGJK, i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore prandaj, mbrojtja gjyqësore e kërkuar nga paditësi, në raport me të paditurin është tërësisht e pabazuar. Përfundimi i gjykatës së shkallës së parë si në aktgjykimin e animuar lidhur me legjitimitetin e palës së paditur, nga gjykata e shkallës së dytë nuk vlerësohet si me ndikim për vendosur ndryshe në këtë çështje juridike për arsye se kërkesëpadia e paditësit vlerësohet si e pabazuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë si në mungesë të bazës juridike të kërkesëpadisë ashtu edhe në mungesë të legjitimitetit real pasiv të palës së paditur e për të cilat arsye kolegji vendosi që ankesën e paditësit ta refuzoj, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetoj si të rregullt dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga se u tha më lart, e në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 200 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1675/2017, me datë 22.01.2021

Kryetarja e kolegjit - Gjyqtarja

Hunaida Pasuli